

LETËR E HAPUR

Për marrjen e masave urgjente për mbrojtjen e Lumit Shkumbin

Drejtuar :

- **Z. EDI RAMA** Kryeministër i Republikës së Shqipërisë;
- **Z. Sofjan Jaupaj** – Ministër i Mjedisit;
- **Z. Ilir Bejtja** - Prefekti i Qarkut Elbasan;
- **Agjencia Kombëtare e Mjedisit;**
- **Inspektorati Shtetëror i Mjedisit;**
- **Autoritetet Vendore(Bashkitë)**
- **ABU Shkumbini (Autoriteti i Basenit Ujëmbledhës Shkumbin)**

Subjekti: Kërkesë për marrjen e masave urgjente institucionale lidhur me ndërhyrjet në Lumin Shkumbin.

Të nderuar! Ne, organizatat e shoqërisë civile dhe grupet lokale nënshkruese, të angazhuara në mbrojtjen e mjedisit dhe interesit publik, paraqesim këtë letër të hapur për të kërkuar marrjen e masave urgjente institucionale, verifikim të ligjshmërisë dhe masa konkrete lidhur me ndërhyrjet e konstatuara në **Lumin Shkumbin** dhe brigjet e tij, veçanërisht në kontekstin e punimeve për ndërtimin e rrugës nacionale **Elbasan–Librazhd–Bushtricë**, si pjesë e Koridorit VIII.

Kjo letër synon:

1. parandalimin e degradimit të mëtejshëm të lumit;
2. garantimin e respektimit të kuadrit ligjor mjedisor dhe të ujërave;
3. transparencë publike mbi lejet, vendimet dhe kushtet e zbatimit;
4. rehabilitimin e segmenteve të dëmtuara dhe vendosjen e përgjegjësisë.

Bazuar në vëzhgime në terren, raportime nga komunitetet lokale dhe dokumentim fotografik dhe video, gjatë zbatimit të punimeve janë evidentuar raste ku subjektet kontraktore:

1. Shfrytëzojnë materiale inerte nga shtrati dhe/ose brigjet e Lumit Shkumbin, duke shkaktuar ndryshime të drejtpërdrejta në morfologjinë e lumit;
2. Depozitojnë dhera, gurë dhe materiale të përfutuara nga gjërmimet (p.sh. nga skarpatat dhe punimet rrugore) në shtratin e lumit.

Këto ndërhyrje, më e pakta do të sjellin përkeqësim të cilësisë së ujit, biodiversitetit dhe habitateve natyrore breglumore prej rritjes së turbullirës dhe ngarkesës së sedimenteve në trupin ujqor, si dhe shtim të rrezikut për erozion, shembje të brigjeve dhe përmytje. Sot edhe pse nuk flitet erozioni i lumenjve është kontribues kryesor i erozionit detar, një tjetër problematikë mjedisore po aq e rëndësishme dhe aktuale sa kjo në fjalë. Duket qartë që lumi ka pësuar një ulje të shtratit më shumë se 1m dhe si rezultat është bërë më i rrëmbyeshëm, shumë toka kanë pësuar rëshqitje masive deri në një rrezik të mnudshëm të rrëshqitje masive të fshatrave.

Për ne, kjo është një katastrofë e mirëfilltë mjedisore me një ndikim i drejtpërdrejtë mbi biodiversitetin dhe ekosistemin natyror dhe për më tej me një impakt thelbësor për komunitetet lokale dhe aktivitetet e tyre, dhe më gjerë, **e si rrjedhojë totalisht e papranueshme.**

Gjatë ditëve të fundit, në segmentin e rrugës nacionale Librazhd-Bushtricë, është regjistruar një rrëshqitje e konsiderueshme dheu, e cila ka dëmtuar rrugën kryesore lidhëse të juglindjes së vendit, duke krijuar ndërprerje të qarkullimit.

Kjo ngjarje e fundit përforcon shqetësimin tonë të ngritur më parë lidhur me ndërhyrjet në shtratin dhe brigjet e Lumit Shkumbin, të cilat kanë ndryshuar morfologjinë natyrore të tij, kanë ulur shtratin dhe kanë rritur dinamikën e rrjedhës, duke destabilizuar brigjet dhe tokat përreth.

Baza ligjore e shkeljeve të konstatuara

Veprimet e mësipërme përbëjnë shkelje të drejtpërdrejta të legjislacionit shqiptar në fuqi, konkretisht:

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, specifikisht
 - a. **Neni 56** për “E drejta e publikut për t’u informuar mbi gjendjen e mjedisit dhe mbrojtjen e tij” dhe
 - b. **Neni 59** për “Objektivat sociale të shtetit, përfshirë garantimin e një mjedisi të shëndetshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm”.
2. Burimet ujore, specifikisht
 - a. **Ligji nr. 29/2024** “Për burimet ujore”, i cili është kuadri aktual për përdorimin, mbrojtjen, monitorimin dhe administrimin e burimeve ujore; kushtet/kompetencat për ndërhyrje në shtrat/brigje dhe përdorim burimi ujqor.
3. Mbrojtja e mjedisit, biodiversiteti dhe lejet, specifikisht
 - a. **Ligji nr. 10431/2011** “Për mbrojtjen e mjedisit”, i cili parashikon parandalimin e ndotjes dhe degradimit, gjithashtu dhe detyrimet institucionale,
 - b. **Ligji nr. 9587/2006** “Për mbrojtjen e biodiversitetit” i cili përcakton mbrojtjen e habitateve dhe faunës/florës së egër.
 - c. **Ligji nr. 10440/2011** “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM)” ku parashikohen detyrimet për vlerësim ndikimi në mjedis dhe kushtet për zbatimin e projektit.
4. Menaxhimi i mbetjeve dhe mbetjeve inerte
 - a. **Ligji nr. 10463/2011** “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.
 - b. **Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24.06.2015** “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.
5. Normat e cilësisë për ujërat sipërfaqësore
 - a. **VKM nr. 246, datë 30.04.2014** “Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësore”.
6. Transparenca, pjesëmarrja publike dhe procedura
 - a. **Ligji nr. 119/2014** “Për të drejtën e informimit” (i ndryshuar).
 - b. **Ligji nr. 146/2014** “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.
 - c. **Ligji nr. 44/2015** “Kodi i Procedurave Administrative”, ku përcaktohet saktë detyrimi për arsyetim, afate, transparencë procedurale, ankime.
 - d. **Ligji nr. 8672, datë 26.10.2000** për ratifikimin e **Konventës së Aarhusit**, ku qartësisht ka një detyrim që organizatat e shoqërisë civile të informohen, ti garantohet pjesëmarrje në vendimmarrje dhe akses në drejtësi për çështje mjedisore.

Sipas informacionit të cituar në draftin tonë dhe dokumenteve të publikuara, rezulton ekzistenca e Vendimit nr. 72, datë 18.04.2025, për miratimin e lejes “për përdorim burimi ujqor” me qëllim shfrytëzimin e materialeve inerte në shtratin e Lumit Shkumbin, për subjektin “Salillari” sh.p.k.

Ne kërkojmë që autoritetet kompetente të monitorojnë dhe të dokumentojnë në mënyrë të plotë:

- (mos)përputhjen e ndërhyrjeve në terren me vendndodhjen, koordinatat, volumet, periudhën dhe kushtet e lejes;
- (keq)zbatimin e detyrimeve për rehabilitim dhe masa parandaluese;
- devijimet apo nënkontraktime e paautorizuara, shkeljet e kushteve të VNM dhe menaxhimit të mbetjeve.

Përdorimi i inerteve lumore për ndërtimin e rrugëve nuk është i lejuar teknikisht, pasi standardet e ndërtimit kërkojnë përdorimin e materialeve nga karriera të licencuara, me parametra gjeoteknikë të kontrolluar dhe të certifikuar.

(Kërkesat tona si më poshtë)

KËRKESAT TONA

Në përputhje me përgjegjësitë ligjore dhe institucionale, ne kërkojmë:

1. Inspektim urgjent dhe raport zyrtar publik

ISHM, AKM dhe ABU, në bashkëpunim me autoritetet vendore dhe institucionet e tjera përkatëse, të kryejnë inspektime në terren në segmentet e prekura të Lumit Shkumbin dhe të hartojnë:

- a) Procesverbal/raport inspektimi me gjetje, prova (foto/koordinata), identifikim përgjegjësish, dhe masa të propozuara;
- b) një plan veprimi me afate (çfarë mase, kush e zbaton, deri kur).

Raporti i inspektimit dhe plani i veprimit të bëhen publik dhe t'u vihen në dispozicion nënshkruesve.

2. Ndërpërprje e menjëhershme e veprimeve të paligjshme (nëse konstatohen)

Pas inspektimit dhe konstatimit të shkeljeve, kërkojmë ndërprerje të menjëhershme të:

- a) nxjerrjes së inerteve nga shtrati/brigjet e lumit jashtë kushteve të lejeve;
- b) depozitimit/shkarkimit të dheut, gurëve apo materialeve inerte në shtratin e lumit.

Marrjen e masave administrative dhe ligjore ndaj subjekteve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi, përfshirë (kur është e nevojshme) referim pranë organeve kompetente për ndjekje të mëtejshme.

3. Monitorim i cilësisë së ujit dhe publikim i rezultateve

AKM të kryejë marrje mostrash (ujë/sedimente) në pikat e prekura dhe kontrolluese, dhe të publikojë rezultatet krahasuar me normat dhe standardet për ujërat sipërfaqësore, në përputhje me VKM nr. 246/2014.

4. Rehabilitim i segmenteve të dëmtuara

Të hartohet dhe miratohet një *PLAN REHABILITIMI* për zonat e dëmtuara (heqje e depozitimeve inerte nga shtrati, stabilizim brigjesh, rikthim i profilin/rrjedhës aty ku është deformuar, masa kundër erozionit), me afate zbatimi, përgjegjësi dhe monitorim.

5. Transparencë dhe akses në dokumente (kërkesë formale për informacion)

Në bazë të Ligjit nr. 119/2014 dhe Konventës së Aarhusit, kërkojmë vënien në dispozicion (brenda afateve ligjore) të kopjeve të dokumenteve si më poshtë:

- a) leje/autorizime për “përdorim burimi ujor” (përfshirë Vendimin nr. 72, datë 18.04.2025 dhe kushtet shoqëruese), vendndodhje/koordinata, volumet e lejuara, afatet, kushtet e rehabilitimit;
- b) vendime lidhur me Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, informacion të detajuar për këshillim mjedisor të këtij projekti dhe/ose vendime/akte mjedisore për projektin/punimet përkatëse;
- c) plan menaxhimi i mbetjeve inerte (origjina, transporti, depozitimi, ripërdorimi) dhe çdo dokument shoqërues sipas VKM nr. 575/2015;
- d) raporte inspektimesh të kryera më parë dhe masat e vendosura.

6. Pjesëmarrje publike dhe mekanizëm monitorimi

Të organizohet një **takim informues/konsultim publik** në zonën e prekur, me praninë e institucioneve, si Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Autoritetet Vendore(Bashkitë), ABU Shkumbini (Autoriteti i Basenit Ujëmbledhës Shkumbin) komunitetit dhe organizatave nënshkruese, ku të prezantohen gjetjet dhe masat si dhe të caktohet një pikë kontakti institucionale (emër/pozicion/email/telefon zyrtar) dhe të vendoset raportim periodik (p.sh. çdo 30 ditë) për progresin e masave.

-

Organizatave dhe grupet nënshkruese shprehin gatishmërinë për të kontribuar me dokumentim nga terreni dhe informacion shtesë, bashkëpunuar në procese monitorimi dhe dialogu institucional dhe jemi gati për të mbështetur **çdo zgjidhje të ligjshme dhe të qëndrueshme që balancojnë zhvillimin me mbrojtjen e mjedisit.**

Kjo letër nuk është kundër zhvillimit; por në mbështetje të një zhvillimi të përgjegjshëm, në përputhje me ligjin dhe interesin publik.

U bëjmë thirrje institucioneve përgjegjëse të reagojnë me veprime konkrete, afate të qarta dhe përgjegjësi të përcaktuara.

Mbrojtja e Lumit Shkumbin është një përgjegjësi institucionale dhe shoqërore.

Veprimi duhet të nisë tani.

Me respekt,

Organizatat e shoqërisë civile dhe grupet lokale nënshkruese.

Nr.	Emërtimi	Logo
1	Shoqata AlbNatyra	
2	Qendra NORMA	
3	Reinforce Sustainability (RESU Albania)	
4	GO2Albania_Organizatë për Planifikim të Qëndrueshëm Urban	
5	Qendra LUMI – Lëvizja për Ujërat, Mjedisin dhe Integrimin	
6	Qendra për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri (PPNEA)	
7	Rrjedha	
8	Qendra Balancë	
9	Qendra për Mbrojtjen e Ekosistemeve Natyrore në Shqipëri (EcoAlbania)	

10	Unë Gruaja	
11	Instituti për Natyrën dhe Konservimin në Shqipëri (INCA Albania)	
12	ILIRIA-Protection and Social & Environmental Development Association (PSEDA-ILIRIA)	
13	Eko mjedisi Durrës	
14	AGRIEN_SHOQATA E BASHKUAR AGRO-MJEDISORE	
15	Qendra Burimore e Mjedisit ne Shqipri (REC Albania)	
16	All-Green Centre	
17	Milieukontakt Albania	
18	Shoqata Ornitologjike e Shqiperise (AOS)	
19	Rrjeti për Raportimin e K.O.K.Sh	

20	Shoqata Ekspertet e Rinj Mjedisor -SHERM Albania	
21	Shtëpia e Gjelbër	
22	Instituti per Menaxhimin e Mjedisit dhe Territorit	
23	Destination Management Organization	
24	Korça Alpin	
25	North Green Association	
26	Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit	